

URDHËR
Nr. 1031, datë 2.9.2025

**PËR ZËVENDËSIMIN E PËRKOHSHËM PËR NËNSHKRIMIN E
DOKUMENTEVE NË EMËR TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Z. Sokol Ismaili, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, që në mungesë dhe me porosi, të zëvendësojë për nënshkrimin e korrespondencave të përditshme shkresore, që janë kompetencë e sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. Gjatë periudhës së zëvendësimit, të shqyrtojë dhe të miratojë çdo akt që kalon nëpërmjet sistemit *e-aktet*, në emër dhe për llogari të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

3. Gjatë periudhës së zëvendësimit të nënshkruajë elektronikisht, në emër dhe për llogari të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në sistemin AFMIS dhe miratimin në sistemin SIFQ.

4. Periudha e zëvendësimit është e vlefshme për periudhën 3.9.2025 deri më 10.9.2025.

5. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Sokol Ismaili, për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit për komunikimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË
SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
Llambriola Misto